



REPUBLIKA E ALBANIË
MINISTRIA E FINANCAVE

KOMISIONI AD-HOC - RENTA MINERARE

VENDIM

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 7 datë 4.01.2012 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare" të ndryshuar, Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 27.04.2012 "Për ngritjen e Komisionit *ad-hoc* për përcaktimin e listave për vlerat referuese sipas normativave teknologjike të produkteve që përdorin minerale", të ndryshuar, Komisioni Ad-Hoc, në mbledhjen e datës 23.04.2015

VENDOSI:

Referuar shkresës nr. prot. 4524, datë 15.04.2015, të dërguar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Komisioni vendosi:

Në Tabelën nr. 1 "Lista e nën-produkteve minerare për të cilët e renta minerare llogaritet mbi vlerën e mineralit të përfshirë në nenprodukt, bazuar në normativat teknologjike dhe çmimin e tregut të mineralit", të Raportit nr. 16365, datë 17.10.2012, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Emërtimet e rreshtave 25-28 "Lastra ranori" zëvendësohet me emërtimin "Lastra dhe pllaka të përpunuara prej tyre". Ndërkohë trashësia e lastrave mbetet e njëjtë ashtu sikurse është përcaktuar në rreshtat 25-28.
2. Në rreshtin 28 shtohen emërtimet: "Bordura dhe kapake guri të sharuara dhe përpunuara" dhe "Gurë për mure dhe kalldrëme të thyera në presë me përmasa të ndryshme". Treguesit do të jenë të njëjtë si në rreshtin 28.
3. Në rreshtin 29 shtohen emërtimet: "Bordura, kapak dhe pllaka natyrore të përpunuara mekanikisht në presa hidraulike". Treguesit do të jenë të njëjtë si në rreshtin 29.
4. Në rreshtin 36 emërtimi "Pllaka ranorësh" zëvendësohet me "Pllaka natyrore të çregullta me trashësi dhe përmasa të ndryshme".

Anëtarët e Komisionit Ad-Hoc:

Nr.	Emri	Pozicioni	Institucioni	Firma
1	Znj. Arjana DYRMISHI	Kryetare	Ministria e Financave	
2	Znj. Elida FARA	Anëtar	Ministria e Financave	
3	Znj. Violeta ZAIMI	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	
4	Z. Ajet LAZE	Anëtar	Drejtoria Rajonale Tatimore	
5	Z. Oltion KUKË	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	
6	Z. Gerti GORENCA	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	
7	Znj. Flutura MADHI	Anëtar	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	
8	Z. Mehmet HASALAMI	Anëtar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	
9	Z. Dritan SPAHIU	Anëtar	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	
10	Z. Azbi ARAPI	Anëtar	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	
11	Z. Agron XHAVO	Anëtar	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	